

**STATUT DHE AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
EUREKA MOON**

Në Durrës, sot në datë 01 Qershor 2021,
me cilësinë e "Ortakut themelues",

z. Artur Çokaj, atësia Ndrec, i datëlindjes 18.06.1967, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 032138899 dhe me nr. personal G70618066E ka hartuar këtë akt themelimi dhe statut të Shoqërisë, në respekt dhe bazuar:

- Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi;
- Në ligjin 9901 datë 14.04.2008, " Per tregtarët dhe Shoqëritë tregtare ";
- Në ligjin " Për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit ";
- Në legjislacionin Fiskal e Tatimor;

Neni 1

Emri i shoqërisë dhe forma ligjore

Shoqëria gëzon emrin **Eureka Moon** dhe është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 2

Selia

Shoqëria e ka selinë në Durrës, Lagja nr.13, Hyrja 1, Apartamenti2, Zona Kadastrale 8518, nr. pasurie 7/96+1-2.

Neni 4

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jete:

Pregatitje website, tregti elektronike, studim dhe kerkim tregu, konsulence ne fushen e makinerive industriale, pregatitja e manualeve te makinerive.

Neni 5


Kapitali themeltar

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100'000 (njqindmije) lekë i ndarë në 1 (nje) kuotë, vlera e të ciles zotërohet nga Ortaku si më poshtë:

- **Z. Artur Çokaj**, zoterues i 1 (nje) kuote, e cila përfaqëson 100 % te kapitalit me vlerën 100'000 (njqindmije) lek.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit



Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të Kapitalit Themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Në asnje rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet, zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që zotërojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit ndërmjet Ortakëve apo personave të treta

Kuotat e kapitalit të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i Shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve, vendos dhe përgjigjet për çështje si :

- përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve periodike të ecurisë së veprimtarisë;
- përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- investime, transferime kuotash, etj;
- vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

Neni 9

Mbledhjet e asamblesë së Ortakëve

Nëse nuk përcaktohet një vend tjetër, Asambleja e Ortakëve i mban mbledhjet e saj në selinë e Shoqërisë.

Çështjet që kërkojnë miratimin e Asamblesë së Ortakëve mund të komunikohen me postë të zakonshme apo edhe me postë elektronike (email) dhe këto komunikime janë të vlefshme kur konfirmohen dhe nënshkruhen nga Ortakët, anëtare të Asamblesë. Thirrja dhe vendimet e

Asamblese se Ortakeve janë të vlefshme kur procedurat kryhen në përputhje me Ligjin e Shoqërive Tregtare.

Neni 10
Administrimi dhe kopetencat

Administrator i Shoqërise emerohet për një afat 5 (pese) vjet me të drejtë riemërimi dhe do të jetë:

z. Artur Çokaj, atësia Ndrec, i datëlindjes 18.06.1967, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 032138899 dhe me nr. personal G70618066E.

Administratori ka kompetenca, mban përgjegjësi dhe ka për detyrë:

- Administratori ka kompetenca e përgjegjësi sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”

Neni 11
Inventari, Pasqyrat dhe Viti Financiar

Viti financiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Përjashtimisht, viti i parë financiar do të fillojë në datën kur Shoqëria është regjistruar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

Në përfundim të çdo viti financiar, administratori përgatit inventarët, pasqyrat financiare dhe raportet, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Fitimi neto i realizuar që ka rezultuar pas zbritjes së shpenzimeve si dhe vlerës së fondit rezervë, u kalon Ortakeve në përputhje me përqindjen e kontributit të tyre në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë ose mund të kalojë për investime, por gjithmone bazuar ne një vendim të shkruar te Asamblesë së Ortakeve.

Mbartja afatgjatë e detyrimeve financiare të Shoqërisë kundrejt të tretëve, institucione bankare apo individëve, ndalon Asamblenë e Ortakëve në ndarjen e dividendëve me prioritet përmirsimin e gjëndjes financiare të Shoqërise dhe rritje të përgjegjësisë dhe përparsisë për fondet që Shoqëria mobilizon për aktivitetin e saj tregtar kundrejt të tretëve duke i dhënë përparësi këtyre të fundit.

Neni 12
Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit civil dhe çfardo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërise.

SHOQËRIA “EUREKA MOON” SH.P.K

ORTAKU

ARTUR ÇOKAJ

Artur Çokaj
